



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE DHE PRONAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 05, datë 29.05.2024

**“PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR APLIKANTËT NË
PROGRAMIN E STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË
KREDISË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, shkresës nr. 407/53 prot. datë 01.08.2022 dhe shkresës nr. 18240/2 prot. datë 31.10.2023, adresuar Bashkisë Dibër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës2024:


PROPOZON

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit, për programin “subveucionimi i interesave të kredisë”, sipas listës bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, Bashkia Dibër;
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e institucionit të Prefektit, Qarku Dibër;

Përgjegjës i Sektori të
Administrimit të Pronave
dhe Strehimit
Gazmend Miftari

Drejtori Juridik

KRYETARI I BASHKISË
RAHËM SPANU



Datë, 29.05.2024

RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKT-VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR APLIKANTËT NË PROGRAMIN E STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, shkresës nr. 407/53 prot. datë 01.08.2022 dhe shkresës nr. 18240/2 prot. datë 31.10.2023, adresuar Bashkisë Dibër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, numri i aplikimeve që janë paraqitur pranë Sektorit të Strehimit, në Bashkinë Dibër në total janë 69 aplikime të mbledhura që nga viti 2017. Referuar shkresës nr. 407/53 prot. datë 01.08.2022 dhe shkresës nr. 18240/2 prot. datë 31.10.2023, adresuar Bashkisë Dibër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për të bërë vlerësimet përkatëse për çdo aplikim, kërkohet nga këshilli bashkiak miratimi i sistemit të pikëzimit, në zbatim të nenit 15, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 përmban 25 pikë. Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi bazuar shkresës nr. 18240/2 prot., datë 31.10.2023.

Sektori i Pronave dhe Strehimit


Juriste
Xhesika Rama



Specialist
Mentor Bitri



Përgjegjës
Gazmend Miftari



**Tabela nr. 1 - Formula e Pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social
"Subvencionimi i interesave të kredisë"**

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
A	Nuk disponon apartament në pronësi	6
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje.	5
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	3
Ç	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pasurta, si rezultat i fatkeqësive natyrore	3
D	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
E	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	5
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë ku përfshihen dhe vajzat uëna	8
B	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	0
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	5
Ç	Familje të reja, është familja e krijuar si rezultat i martesës së lidhur përpara nëpunësit të gjendjes civile ose bashkëjetesës së deklaruar para noterit publik, sipas Kodit të Familjes, kur moshja e anëtarit më të madh të të cilës në momentin e paraqitjes së kërkesës është më e vogël ose baras me 40 vjeç	8
D	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	4
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
A	Personat me aftësi të kufizuara, sipas pikës 28 të nenit 2 të këtij ligji.	6
B	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç.	4

C	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve.	2
Ç	Emigrantët e rikthyer, punëtorët migrantë dhe refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese", në kuptim të legjislacionit përkatës.	2
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0
DH	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH).	0
E	Punonjësit e repartit RENEA.	0
F	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.	0
G	Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.	3
GJ	Anëtarët e komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian.	3
H	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, pas ekzekutimit të dënimit.	2
I	Vajzat nëna.	3
J	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI.	0
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare.	10
B	Të ardhura deri 70% - 100% të të ardhurave mesatare.	8
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare.	7

Sektori i Pronave dhe Strehimit

Juriste
Xhesika Rama



Specialist
Mentor Bitri



Fërgjegjës
Gazmend Miftari

